

## **D E T Y R E   P R O J E K T I M I D H E S P E C I F I K I M E T T E K N I K E**

Detyra e projektimit përmban studimin, rehabilitimin, përmirësimin e skemave të kullimit të ujitjes dhe mbrojtjes nga permbytjet, me qëllim rritjen e aftësisë ujtese, kulluese aktuale dhe marrjen e masave për eliminimin e permbytjeve në sezonin e dimrit:

1.    Vepra e Marrjes Mat-Lezhe
2.    Perforcimi i struktureve të demtuar në Tunelin Nr.1, Gur i Zi
3.    Rehabilitimi i nyjes së derdhjes së KK-3 në Lumin Droje
4.    Ndërtim i Kaskadës Shkarkuesi Mal-Bardhe
5.    Mbrojtja nga lumi Vermosh, ana e majte e rrjedhës;  $L = 350$  m
6.    Argjinatura Ishull Shengjin, krah i majte i rrjedhës;  $L = 350$  m
7.    Perroi i Thate, Malesi e Madhe krah i majte i rrjedhës;  $L = 250$  m

## **I. PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES**

### **1. Vepra e Marrjes Mat-Lezhe**

Vendndodhja: Bashkia Lezhe

Rrethi i Lezhes ka rreth 16 000 ha toke bujqesore. Kanali ujites Magjistrali Mat-Lezhe eshte vepra me e madhe ujtese e rrethit me aftesi rreth 5 000 ha. Me gjatesi rreth 16 km sherben per ujitjen e tokave bujqesore te zones nga fshati Pllane deri ne fshatin Ishull Lezhe. Kapaciteti percjelles i projektuar eshte 5.5 m<sup>3</sup>/sek dhe furnizohet me uje nga Lumi Mat, nepermjet Vepres se Marrjes tek Ura e Vjeter e Matit. Kanali kalon ne kuota te larta rreze vargmalit Pllane-Lezhe dhe furnizon me uje nente kanale te dyte ujites.

Problem i vazhdueshem mbetet futja e ujit nga vepra e marrjes si rezultat i ndryshimit te konfiguracionit te shtratit te lumit Mat nga marrja pa kriter e zhavoreve si dhe sasise jo te mjaftueshme te ujit qe leshojne Hidrocentralet e Shkopetit dhe Qafe Molles ne periudhen e veres.

Çdo vit Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhe eshte e detyruar te beje nje argjinate prej guri dhe zhavorri qe te ngreje nivelin e ujit per tu futur ne kanalin ujites.

Per shkak te problematikave te ndodhura ne Uren e Zogut Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhe pas perfundimit te sezonit te ujitjes ben kthimin e shtratit te lumit ne gjendjen e mepareshme.

Sa siper kerkohet nderhyrja per te ndertuar nje veper marrje te perhereshme duke konsideruar dhe furnizimin me uje te Kanalit Ujites Mat-Kurbin.

Sipas llogoritjeve paraprake te kryera nga grupi i punes per realizimin e ketyre punimeve nevojiten nje fond prej rreth **66 000 000** leke me tvsh .

#### **• FAZAT E SHERBIMIT – VEPRA INXHINIERIKE**

-FAZA IV - Projektet për miratimin e lejes së ndërtimit

-FAZA V - Projektet e zbatimit

-FAZA VI - Preventivat përfundimtar

#### **• FAZAT E SHERBIMIT – SHERBIME NENTOKES DHE PUNIMET E THEMELEVE**

-FAZA I - 1. Qartësimi i kërkesave të projektit. 2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipastesteve të kërkuara.

-FAZA II - 1. Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve, laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës; 2. Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji; 3. Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.

-FAZA III - 1. Paraqitja e rekomandimeve përqëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit; 2. Deklaratë mbi çedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final, siç paraqitet tek neni 39; 3. Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.

- **FAZAT E SHERBIMIT – NDIKIMI NE MJEDIS**

-FAZA I - Aplikimi për VNM paraprake

-FAZA II - Njoftim për rastet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM

-FAZA III- Organizimi i degjës Publike për konsultimin e draft raportit të VNM-se të thelluar

-FAZA VI - Aplikimi për deklaratë Mjedisore



## **2. Perforcimi i strukturese demtuar ne Tunelin Nr.1,Gur i Zi**

Vendndodhja: Bashkia Vau Dejes

Kanali i Rragamit eshte nje nga veprat kryesore per ujitje me rrjedhje te lire per rrethin e Shkodres dhe Malesine e Madhe.

Ky kanal merr uje ne Liqenin e HEC-it te Vau Dejes per tu bashkuar me kanalin ujites te Ujembledhesit Shtoder ne dalje te ujeleshuesit te tij.Ky kanal ka tre tunele.Ne zonen e Gurit te Zi ky kanal kalon nepermjet tunelit Nr.1 me gjatesi 550 ml.Ne mesin e tij ky tunel ka pesuar nje demtim te strukturave ne nje segment rreth 30 m.

Detyra e projektimit kerkon te hartohet projekti per perforcimin e strukturese te demtuar ne kete segment.

Vlera e ketij investimi eshte **7 080 000** leke me tvsh

- **FAZAT E SHERBIMIT – VEPRA INXHINIERIKE**

-FAZA IV - Projektet për miratimin e lejes së ndërtimit

-FAZA V - Projektet e zbatimit

-FAZA VI - Preventivat përfundimtar

- **FAZAT E SHERBIMIT – NDIKIMI NE MJEDIS**

-FAZA I - Aplikimi për VNM paraprake


-FAZA II - Njoftim per rastet qe duhet te trajtohen ne raportin e thelluar te VNM

-FAZA III- Organizimi I degjeses Publike per konsultimin e draft raportit te VNM-se te thelluar

-FAZA VI - Aplikimi për deklaratë Mjedisore

464279.130  
4659152.281

465204.530  
4659152.281



464279.130  
4659152.281

465204.530  
4659152.281

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.  
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

0 50 100 200 m

**Legjenda**

Shtresë

Rang

di 3

I

nga

di 2

Rendi 1 (Kufiri)

Sistemi Koordinativ: KRGJSH

Projektimi: KRGJSH

### **3. Rehabilitimi i nyjes se derdhjes se KK-3 ne Lumin Droje**

Vendndodhja: Bashkia Kurbin

Kanali KK-3 eshte nje nga kanalet e sistemit kullues te rrethit te Kurbin. Kullon nje siperfaqe toke prej rreth 850 ha. Eshte i projektuar rreth viteve 1960 te derdhet ne dy menyra. Kur niveli i ujit ne lumin Doje eshte i ulur ky kanal derdhet me rrjedhje te lire ne te. Ndersa kur ngrihet niveli ne lumin Droje ky kanal kullon me ngritje mekanike ne Hidrovorin Droje.

Pas viteve 1990 eshte demtuar nyja e komandimit per kullimin me rrjedhje te lire dhe aktualisht e gjithje siperfaqja kullon me ngritje mekanike me ane te Hidrovorit te Drojes.

Detyra e projektimit kerkon te rindertohet nyja e komandimit te ketij kanali me lumin Droje.

Vlera e ketij investimi eshte **6 960 000** leke me tvsh.

- **FAZAT E SHERBIMIT – VEPRA INXHINIERIKE**

-FAZA IV - Projektet per miratimin e lejes se ndertimit

-FAZA V - Projektet e zbatimit

-FAZA VI - Preventivat përfundimtar

- **FAZAT E SHERBIMIT – SHERBIME NENTOKES DHE PUNIMET E THEMELEVE**

-FAZA I - 1. Qartësimi i kërkesave të projektit. 2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.

-FAZA II - 1. Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve, laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës; 2. Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji; 3. Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.

-FAZA III - 1. Paraqitja e rekomandimeve përqëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit; 2. Deklaratë mbi çedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final, siç paraqitet tek neni 39; 3. Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.

- **FAZAT E SHERBIMIT – NDIKIMI NE MJEDIS**

-FAZA I - Aplikimi për VNM paraprake

-FAZA II - Njoftim për rastet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM

-FAZA III - Organizimi i degjës Publike për konsultimin e draft raportit të VNM-se të thelluar

-FAZA VI - Aplikimi për deklaratë mjedisore



## Rehabilitim i nyjes se derdhjes se KK-3 ne Lumin Droje

<https://geoportal.asig.gov.al>  
Data e Printimit: 16.09.2025

460609.535  
4604215.102

460614.935  
4604215.102



460609.535  
4603004.702

460614.935  
4603004.702

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron te dhena gjeohapësinore te ofruara nga  
autoritetet publike përgjegjëse.  
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar  
ato.

0 50 100 200 m

**Legjenda**

Shtrese

di 3

di 2

Rendi 1 (kufir)

Rendi 2 (kufir)

Sistemi Koordinativ: XKR03SH

Projeksimi: KRGJSH

#### **4. Ndertim i Kaskades Shkarkuesi Mal-Bardhe**

Vendndodhja: Bashkia Kurbin

Kanali Ujites U-1 nga priza e marrjes ne Milot deri tek portat e para (ne fshatin Shullaz) me gjatesi 2.4 km, jashte sezonit te ujitjes sherben si KUL-Milot dhe KUL Kurbin, duke shkarkuar ne lumin Mat nepermjet shkarkuesit ne Mal Bardhe.

KUL Kurbin fillon tek nderprerja me uren e hekurudhes se ish Kombinatit Kimiko Metalurgjik duke marre ujrat e Perroi te Laçit. Leviz ne drejtim te veriut grumbullon ujrat e larta te kesaj zone, merr dhe perroin e Delbnishtit dhe derdhet ne lumin Mat nepermjet shkarkuesit te Malit te Bardhe.

Segmenti fundor i tij nga Portat e Shullazit deri te Shkarkuesi Mal Bardhe ne sezonin e ujitjes sherben si Kanal Ujites duke i levizur ujrat ne drejtim te kundert ne drejtimin Veri-Jug. Kjo behet e mundur nepermjet mbylljes se shkarkuesit Mal Bardhe.

Ne kete segment ne kete kanal derdhen dhe Perrenjte Malore te Sherbeles dhe te Mal Bardhes.

Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit Lezhe i duhet qe te mbylle Shkarkuesin ne Mal Bardhe me dhe ne fillim te sezonit ujites dhe ta hapi ate ne perfundim te tij. Mbyllja behet me dhe te grumbulluar.

Gjate viteve eshte krijuar problem per sasine e dheut qe duhet per ta mbyllur.

Detyra e projektimit kerkon te hartohet projekti per ndertimin e nje vepre te perhereshme me porta dhe kaskade per mbylljen e shkarkuesit.

Vlera e ketij investimi eshte **12 600 000** leke me tvsh

- **FAZAT E SHERBIMIT – VEPRA INXHINIERIKE**

-FAZA IV - Projektet për miratimin e lejes së ndërtimit

-FAZA V - Projektet e zbatimit

-FAZA VI - Preventivat përfundimtar

- **FAZAT E SHERBIMIT – SHERBIME NENTOKES DHE PUNIMET E THEMELEVE**

-FAZA I - 1. Qartësimi i kërkesave të projektit. 2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.

-FAZA II - 1. Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve, laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës; 2. Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji; 3. Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.

-FAZA III - 1. Paraqitja e rekomandimeve përqëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themlit; 2. Deklaratë mbi

çedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final, siç paraqitet tek neni 39; 3. Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.

- **FAZAT E SHËRBIMIT – NDIKIMI NE MJEDIS**

-FAZA I - Aplikimi për VNM paraprake

-FAZA II - Njoftim për rastet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM

-FAZA III- Organizimi i degjës Publike për konsultimin e draft raportit të VNM-se të thelluar

-FAZA VI - Aplikimi për deklaratë Mjedisore



## **5. Mbrojtja nga lumi Vermosh, ana e majte e rrjedhes; L = 350 ml**

Vendndodhja: Bashkia Malesi e Madhe

Lumi i Vermoshit leviz pergjate fshatit Vermosh dhe derdhet jashte kufijve teritorial te Republikes se Shqiperise. Ne zonen e banuar ka krijuar mjaft probleme ne brigjet e tij.

Gjate reshjeve te dendura te shiut Lumi sjell sasi te madhe uji dhe prurje te ngurta duke rrezikuar erozionin dhe zhavorrizimin e tokave perreth tij.

Gjate vitit 2024 u investua nga ana e Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit Lezhe ne tete segmente te ketij lumi.

Gjate vitit te fundit si pasoje e akumulimit te aluvioneve ne shtratin e tij, ka sjell erozion te brigjeve ne anen e majte te rrjedhes sidomos ne nje segment prej 350 ml.

Kerkohet te behet rehabilitimi i ketij perroi ne segmentin me problematik te tij.

Vlera e ketij investimi eshte **25 200 000** leke me tvsh

- **FAZAT E SHERBIMIT – VEPRA INXHINIERIKE**

-FAZA IV - Projektet per miratimin e lejes se ndertimit

-FAZA V - Projektet e zbatimit

-FAZA VI - Preventivat përfundimtar

- **FAZAT E SHERBIMIT – SHERBIME NENTOKES DHE PUNIMET E THEMELEVE**

-FAZA I - 1. Qartësimi i kërkesave të projektit. 2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.

-FAZA II - 1. Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve, laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës; 2. Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji; 3. Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.

-FAZA III - 1. Paraqitja e rekomandimeve përqëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit; 2. Deklaratë mbi çedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final, siç paraqitet tek neni 39; 3. Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.

- **FAZAT E SHERBIMIT – NDIKIMI NE MJEDIS**

-FAZA I - Aplikimi për VNM paraprake

-FAZA II - Njoftim për rastet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM

-FAZA III - Organizimi i degjës Publike për konsultimin e draft raportit të VNM-se të thelluar

-FAZA VI - Aplikimi për deklaratë mjedisore



# Mbrojtje nga Lumi Vermosh, ana e majte e rrjedhes

<https://geoportal.asig.gov.al>  
Data e Printimit: 16.09.2025.

473361.421  
4718062.108

474286.821  
4718062.108



473361.421  
4717471.700

474286.821  
4717471.700

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

0 50 100 200 m

## Legjenda

Shtresë

Rang

di 3

I

di 2

di 1

Rendi 1 (Kufiri)

Sistemi koordinativ: KRGSJH

Projektori: KRGSJH

## **6. Argjinatura Ishull Shengjin,krahu i majte i rrjedhes;L = 350 ml**

Vendndodhja: Bashkia Lezhe

Drini i Lezhes fillon prej argjinatures se Mjedes ne hidrocentralin e Vaut te Dejes dhe derisa bashkohet me lumin Gjader pershkon nje gjatesi prej 22 km ne fushen e Zadrimes dhe ka nje siperfaqe ujembledhese prej 45 km<sup>2</sup>.

Lumi Drini i Lezhes nga fshati Gjader ku ne te derdhet dhe lumi Gjader deri ne derdhje ka nje gjatesi prej 22 km. Ne kete lume derdhen Kanali i Ujrave te Larta Zadrime, Hidrovori Grykezeze, Hidrovori Balldre, Hidrovori Gocaj dhe perroi i Manatise.

Siperfaqja ujembledhese e gjithë lumit Drin i Lezhes eshte 314 km<sup>2</sup>.

Lumi Drin i Lezhes nga grykederdhja ne detin Adriatik deri ne grykederdhjen e lumit Gjader eshte i rehabilituar ne vitin 2007.Argjinatura e krahut te djathte te rrjedhes ne afro 5.5 km e fundit u rehabilitua ne vitin 2018.

Problem mbetet krahu i majte i rrjedhjes duke filluar nga nderprerja me Superstraden dhe rreth 2 km ne drejtim te rrjedhjes.

Detyra e projektimit kerkon te hartohet projekti per nje segment tjeter ne vazhdim te tij me gjatesi rreth 350 ml i argjinatures ne krahun e majte te rrjedhes ne Ishull Lezhe.

Vlera e ketij investimi eshte **27 044 554** leke me tvsh

### **• FAZAT E SHERBIMIT – VEPRA INXHINIERIKE**

-FAZA IV - Projektet për miratimin e lejes së ndërtimit

-FAZA V - Projektet e zbatimit

-FAZA VI - Preventivat përfundimtar

### **• FAZAT E SHERBIMIT – NDIKIMI NE MJEDIS**

-FAZA I - Aplikimi për VNM paraprake

-FAZA II - Njoftim per rastet qe duhet te trajtohen ne raportin e thelluar te VNM

-FAZA III- Organizimi I degjeses Publike per konsultimin e draft raportit te VNM-se te thelluar

-FAZA VI - Aplikimi për deklaratë Mjedisore



<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetat publike përgjegjëse. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

0 100 200 400 m

Sistemi koordinativ: KRQJSH  
Projekimi: KRQJSH

## **7. Perroi i Thate ,Malesi e Madhe krah u i majte i rrjedhes;L = 250 ml**

Vendndodhja: Bashkia Malesi e Madhe

Perroi i Thate eshte nder perrenjte kryesore te Bashkise Malesi e Madhe.Ky perrua grumbullon ujrat qe nga Qafe Thora dhe me gjatesi rreth 40 km derdhet ne Liqenin e Shkodres.

Gjate reshjeve te dendura te shiut Perroi sjell sasi te madhe uji dhe prurje te ngurta duke rrezikuar erozionin dhe zhavorrizimin e tokave perreth tij.

Gjate viteve te fundit si pasoje e akumulimit te aluvioneve ne shtratin e tij,ka sjell erozion te brigjeve ne te dy anet e tij sidomos ne 7 km e fundit duke filluar nga kryqezimi me rrugen Koplik-Hani i Hotit deri ne derdhjen ne Liqen.

Nder vite eshte nderhyre me investime shtetore dhe private per te mbrojtur keto banesa dhe parcelat bujqesore duke bere mbrojtje me gabiona ne brigjet e Perroit.

Me problematike paraqitet gjendja ne krahun e majte te rrjedhjes me nje gjatesi rreth 250 ml.Ne kete segment vazhdimisht ky Perrua ka krijuar probleme jo vetem per parcelat bujqesore por dhe per banesat e fshatit.

Kerkohet te behet rehabilitimi i ketij perroi ne segmentin e percaktuar

Vlera e ketij investimi eshte **18 000 000** leke me tvsh

### **• FAZAT E SHERBIMIT – VEPRA INXHINIERIKE**

-FAZA IV - Projektet per miratimin e lejes se ndertimit

-FAZA V - Projektet e zbatimit

-FAZA VI - Preventivat përfundimtar

### **• FAZAT E SHERBIMIT – NDIKIMI NE MJEDIS**

-FAZA I - Aplikimi per VNM paraprake

-FAZA II - Njoftim per rastet qe duhet te trajtohen ne raportin e thelluar te VNM

-FAZA III- Organizimi I degjeses Publike per konsultimin e draft raportit te VNM-se te thelluar

-FAZA VI - Aplikimi per deklarate Mjedisore



## II. QELLIMI I PROJEKTIT

Rritja e aftësisë ujtesë dhe te kullimit të këtyre veprave drejt asaj të projektuar dhe mbrojtja nga permbytja e tokave bujqesore.

## III. OBJEKTIVAT

Objektivi kryesor është rritja e aftësisë ujtesë dhe te kullimit te ketyre veprave dhe mbrojtja nga permbytja e tokave bujqesore si për rrjedhojë edhe rritja e prodhimit bujqësor, punësimit dhe mirëqenies në zonat ku shtrihen skemat ujtesë dhe kulluese.

## IV. KERKESAT

Për objektet e përshfira në këtë shërbim konsulenti duhet të hartojë:

### 1 – Raport Studimor Paraprak

Në këtë raport studimor Konsulenti duhet të studiojë skemën ujtesë dhe te kullimit ekzistuese, nga burimi ujqor, rrjeti i kanaleve kryesor dhe sekondar. Ky raport duhet të përmbajë:

#### 1.1 Inspektim vizual dhe përshkrim i gjendjes aktuale të skemës dhe inventarizim

Përshkrimi duhet të përmbajë relacion shpjegues mbi mënyrën e funksionimit të skemës ekzistuese. Aftësia aktuale te skemës tujtesë dhe te kullimit.

#### 1.2 Metodologjia e ndërtimit

Konsulenti duhet të përshkruajë për këtë fazë mënyrën se si do të ndërtohet vepra nga pikpamja teknike, llogjistike dhe programore, ku do merren dherat sa do behen analiza laboratorike gjate zbatimit

#### 1.3 Korografi

Konsulenti duhet të hartojë një koreografi në shkallën 1:10,000 ku të tregohet i gjithë rrjeti i kanaleve të shoqëruar me reperat referues në kuota absolute (në hartë dhe në formë tabele).

#### 1.4 Planimetri

Konsulenti duhet të hartojë një planimetri në harta të shkallës Sh:1: 25000 dhe 1:10000 e shtrirjes së skemës me izoipse që tregojnë:

- i) Emertimin e skemës dhe Bashkëveprën përkatëse.
- ii) Zonën ku bëhet rehabilitimi i vepres, rruget, fshatrat, qytetet, vepra dhe n/veprat e saj.
- iii) Sipërfaqen që mbulon
- iv) Veprat e artit ekzistuese apo të reja që rehabilitohen (Shk 1:10,000).
- v) Zonat e veprave që do trajtohen (Sh. 1:10,000)
- vi) Legjenden.

Planimetria do të përpunohet edhe në versionin AUTOCAD

#### 1.5 Relacion teknik

Ky relacion do të trajtojë çështjet teknike që lidhen me veprat dhe masat e zgjidhjeve teknike për përmirësim apo modernizim të tyre. Relacioni do të përmbajë:

- i) Gjendjen ekzistuese të veprave
- ii) Gjatesitë e kanaleve, argjinaturave apo perrenjeve që rehabilitohen.
- iii) Punimet në këto vepra
- iv) Punimet në veprat e artit që riparohen, numri dhe tipi i veprave të artit që do të riparohen.
- v) Karakteristikat e tokës për pjesët e veçanta të objektit (studim gjeologjik)
- vi) Studimin hidrologjik

Për hartimin e Raportit Paraprak, Konsulenti duhet të studiojë dhe të marrë në konsideratë çdo projekt apo studim të mëparshëm që ndodhet në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit, apo burim zyrtar tjetër.

Ky raport do të dorëzohet 30 ditë pas datës së fillimit të kryerjes së shërbimit.

## 2 – Faza e Projektimit

Këtu do të përfshihen:

#### 2.1 Rilevimi

Konsulenti duhet të hartojë rilevimin e skemës me rrjetin e kanaleve ku përfshihen:

- i) rilevimi me kuota absolute i kanalit të përfshirë në rehabilitim
- ii) rilevimin me kuota absolute të aksit të skolierës (batimetri)

ii) profila tërthorë minimumi në çdo 70 m dhe të detyrueshëm në kthesa, ndryshime seksioni, vepra arti.

## 2.2 Projekt Zbatimi

Konsulenti do të hartojë projektet e zbatimit për objektet e përfshira në rehabilitim. Rehabilitimi do të konsistojë në ruajtjen e zgjidhjeve teknike të projektit fillestar dhe ndryshime, zgjidhje të reja, plotesime me vepra arti në varësi të kushteve aktuale ku ndodhet skema.

## 2.3 Volumet dhe Preventivi

Konsulenti do të hartojë volumet paraprake për të gjitha kategoritë e punimeve të projektit. Volumet do të llogariten mbi bazë të vizatimeve të projektit. Çmimet njesi për të gjitha punimet do të llogariten duke patur si referencë çmimet mesatare të miratuara me manualët në fuqi.

Konsulenti duhet të paraqesë tabelat e volume kryesore të punës dhe të veprave të artit sipas piketave.

## 2.4 Llogaritjet përfundimtare

Në këtë fazë, Konsulenti duhet të paraqesë një raport ku të përfshihen të gjitha llogaritjet, të cilat duhet të jenë të bazuara në Standardet Shqiptare dhe në Manualët e Çmimeve të Ndërtimit në fuqi.

# 3 - Raportimi

Raportet dhe dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe në tre kopje origjinale. Punimet duhet të jenë të kompiuterizuara me metodat bashkëkohore (Word, Excel, AutoCad etj.)

Punimet duhet të dorëzohen dhe në kopje elektronike në version që janë punuar.

Konsulenti duhet të përfundojë punën brenda 40 ditësh .

# 4 – Marrja në dorëzim

Marrja në dorëzim e dokumentacionit të shërbimit (raporte, projekte etj.) do të bëhet nga grup me specialistë të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhe.

**Në hartimin e Raportit Studimor Paraprak dhe projekteve të zbatimit do të shfrytëzohet edhe arkiva e teknike e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit. Për këtë qëllim, firma konsulente e interesuar, përpara se të dorëzojë ofertën e saj, duhet të marrë kontakte me Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit dhe institucionet e tjera në lidhje me disponibilitetin e materialeve që do ti nevojiten.**

**Fondi Limit për kryerjen e këtij shërbimi është 6,148,362.49 Lek pa TVSH**